

ISSN: 2521-831X

Volumi / Volume Nr.5

Numri / Issue 54

Qershor/June - 2021

**BULETINI
M U J O R
KLIMATIK**

**CLIMATE
MONTHLY
BULLETIN**

UPT – IGJEUM

Departamenti i Klimës dhe Mjedisit

PUT – IGEWE

Department of Climate and Environment



Tirana, Albania © 2021



Koha e vërtimit për elementët meteorologjikë është shumë e rëndësishme. Ajo duhet të përmbushë standardet e OBM. Ajo duhet të jetë e njëjtë për secilin vend, duke ju referuar orës lokale që lidhet me momentin e lindjes së diellit.

The time observation for meteorological elements is very important. It has to fulfill the standards of WMO. It should be the same for each country referring to local time, that refers to the sun rise moment.



BULETINI MUJOR KLIMATIK

CLIMATE MONTHLY BULLETIN

QERSHOR / JUNE 2021
Nr.54

Përmbledhje. Muaji qershor 2021 u karakterizua me një tendencë në rritje graduale të temperaturave të ajrit, të cilat shënuan një shmangie me $+2.2^{\circ}\text{C}$ kundrejt normës. Anomalitë me të theksuara u vërejtën në temperaturat maksimale të ajrit me $+4.3^{\circ}\text{C}$. Nderkohe reshjet shënuan një rënie kundrejt vlerave mesatare shumëvjeçare të periudhës 1961÷1990 me -36.1% , ndërsa numri i ditëve me reshje mbi pragun 1.0mm shënoi një rënie me -24.9% . Në shkallë vendi vetëm pjesa JL e vendit u karakterizua me vlera të reshjeve mbi norme. Duhet theksuar se gjatë këtij muaji u vërejtën dhe një sërë netesh tropikale, ndërkohë që temperaturat maksimale të ajrit në mesditë arritën vlera mëjaft të larta, por nuk shënuan thyerje të rekordeve kombëtare nga pikepamja historike e vërtetimeve meteorologjike. Në vijim të vlerësimit të karakteristikave meteorologjike të muajit qershor jepën dhe disa të dhëna mëjaft të rendesishme për bujqësinë, siç janë vlerat e treguesit të $\sum TA > 10^{\circ}\text{C}$ dhe të NDVI. Të dhënat mbi shpejtësinë e erës në lartësinë 120 metra nga sipërfaqja e tokës për muajin qershor është një informacion tjetër me rendësi për përlogaritjen e fuqisë së erës, i konsideruar si një burim energjie të rinovueshme. Nga dukuritë e vecanta atmosferike evidentohet prania e pluhurit afrikan përgjatë disa ditëve në fund të muajit. Informacioni shkencor me disa të dhëna mbi diellin si një faktor i rendesishëm në formimin e klimes përmbyll këtë buletin.

Summary. June 2021 was characterized by a gradual upward trend in air temperatures, which marked a deviation of $+2.2^{\circ}\text{C}$ against the norm. The most pronounced anomalies were observed at maximum air temperatures of $+4.3^{\circ}\text{C}$. Meanwhile, the precipitation marked a decrease against the norm values of the period 1961÷1990 by -36.1% , while the number of days with precipitation above the 1.0mm threshold marked a decrease of -24.9% . Nationwide only the SE part of the country was characterized by above rainfall norm values. It should be noted that during this month a series of tropical nights were observed, while the maximum air temperatures at noon reached quite high values, but did not break national records from the historical point of view of meteorological observations. Following the assessment of the meteorological characteristics of June, are given some very important data for agriculture, such as the values of index of the $\sum TA > 10^{\circ}\text{C}$ and NDVI. Data on wind speed at an altitude of 120 meters above the ground for the month of June is another important piece of information for calculating wind power, considered as a renewable energy source. Special atmospheric phenomena show the presence of African dust during a few days at the end of the month. Scientific information with some data on the sun as an important factor in climate formation concludes this bulletin.

TABELA E PËRMBAJTJES / TABLE OF CONTENT

Përmbledhje	3	Summary	3
Situata sinoptike.....	5	The synoptic situation	5
Temperaturat e ajrit.....	6	Air temperatures.....	6
Reshjet atmosferike.....	14	Atmospheric precipitation.....	14
Moti ekstrem	21	Extreme weather	21
Agrometeorologji.....	25	Agrometeorology.	25
Energjitë e rinovueshme.	27	Renewable energies.....	27
Ndryshimet Klimatike.....	29	Climate Change.....	29
Informacione shkencore.....	31	Scientific information	31




Tre momentet kryesore të vëzhgimeve meteorologjike janë ato të orëve 7:00, 14:00 dhe 21:00. Përndryshe, të dhënat nuk mund të krahasohen mes tyre. Për Shqipërinë keto orë më saktësisht janë 06:40, 13:40 dhe 20:40. Vëzhgimet nuk ndryshojnë në kohë edhe kur ndryshon koha zyrtare në pranverë dhe vjeshtë. Për vendet me sipërfaqe të madhe, ajo ndryshon në bazë të brezit orar. Orët në fjalë janë referenca dhe për stacionet automatike me matje më të shpeshta në kohë.

The three main hours of meteorological observations are that of 7:00, 14:00 and 21:00. Otherwise, the data can't be compared between them. For Albania those time moments more precisely are 06:40, 13:40 and 20:40. The observations don't change in time even when change the official time in spring and autumn. For countries with large surface, it changes based to time zone. The respective hours are reference points also for the automatic station with more frequent measurements in time.

SITUATA SINOPTIKE

për muajin qershor 2021 pasqyrohet nëpërmjet disa prej hartave të përzgjedhura sinoptike në shkallë kontinentale për datat 1, 11, 21 & 30 qershor 2021, të cilat janë paraqitur në figurën Nr.1 (me presion të lartë - H dhe të ulët - L).



THE SYNOPTIC SITUATION

for the month of June 2021 is reflected through some of the selected synoptic maps on a continental scale for the dates 1, 11, 21 and 30 June 2021, which are presented in figure No.1 (with high atmospheric pressure - High and low - Low).




Figure Nr.1 - Situata sinoptike të datave: 1, 11, 21 dhe 30 qershor 2021. Synoptic situation for the date: 1, 11, 21 and 30 June 2021.

Sa i takon situatës sinoptike të muajit qershor në rajonin tonë ka mbizotëruar një gjendje e qendrueshme. Përgjithsisht kanë mbizotëruar qendrat barike të presionit atmosferik të lartë dhe kjo ka sjellë mot të kthjellët. Sa i përket qendrave barike, të cilat ishin të pranishme por në shpërndarje kohore të parregullt, prania e tyre solli vranësira të çrregullta dhe reshje orografike në zona të ndryshme të vendit. E veçantë është prania e pluhurit afrikan në fund muaji.

Regarding the synoptic situation of June in our region, a stable situation has prevailed. Baric centers of high atmospheric pressure have generally prevailed and this has brought clear weather. In terms of baric centers which were present but in irregular time distribution, their presence brought irregular clouds and orographic precipitation in different areas of the country. Special phenomena is the presence of african dust at the months end.



Pamje nga pluhuri afrikan më datë 30.06.2021 në pjesën qendrore të Shqipërisë. View of african dust on date 30.06.2021 in the central part of Albania (foto: G. Çela).

Temperaturat e ajrit gjatë muajit qershor 2021 në shkallë globale shënuan vlera 0.21°C më të larta se vlerat e normës 1991÷2020, por rreth 0.15°C më të ulta se muaji qershor 2019 dhe 2020. Sa i takon anomalive të temperaturave të ajrit për kontinentin European ato ishin më të mëdha kundrejt atyre globale me një vlerë prej 1.5°C mbi normë. I vetmi muaj qershor që pati vlera më të larta se ky i këtij viti ishte ai i vitit 2019. Për ilustrim një informacion më i detajuar hapësinor paraqitet në figurën Nr.2 nëpërmjet hartave të këtyre anomalive si në shkallë globale ashtu dhe Europiane.



Air temperatures during June 2021 in global scale marked 0.21°C higher than the values of the period 1991÷2020, but about 0.15°C lower than June 2019 and 2020. Regarding the anomalies of air temperatures for the European continent they were larger versus global ones with a value of 1.5°C above the norm. The only month in June that had higher values than this year was June 2019. For illustration a more detailed spatial information is presented in Figure No.2 through maps of these anomalies at both global and European scales.




Figure Nr.2 - Anomalitë e temperaturës së ajrit pranë sipërfaqes për muajin qershor 2021 kundrejt periudhës 1991÷2020. / Surface air temperature anomaly for June 2021 compare to the period 1991÷2020 (Copernicus, ECMWF, etc).




Figura Nr.3. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe anomalive të tyre për kontinentin European për muajin qershor 2021, sipas NOAA-s. / Values of mean air temperatures and their anomalies for the European continent for the month of June 2021, according to NOAA.

Dhjetëditëshi i treti i muajit qershor 2021 u karakterizua me temperatura mjaft të larta, duke

The last ten days of June 2021 were characterized by quite high temperatures, conveying

përcjellë dhe valën e parë të të nxehtit. Në vijim në figurën Nr.4 paraqitet një pamje e kësaj situatë meteorologjike.

the first wave of heat. In the following is a picture of this meteorological situation in Figure No.4.

Figura Nr.4. – Pamje ilustrative e situatës së parë të valëve të nxehtit në Europë në mes të muajit qershor 2021. / Illustrative view of situation of first heatwave at mid-June 2021 for Europe.





Figura Nr.5 - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2021 për Shqipërinë. / Values of mean air temperatures for some meteorological stations of June month 2021 for Albania.

Në territorin e Shqipërisë për muajin qershor 2021 temperaturat mesatare të ajrit u shoqëruan nga një rritje graduale, e cila më e theksuar ishte në dhjetëditëshin e fundit. Në figurën Nr.5 paraqiten disa të dhëna të vendmatjeve meteorologjike për temperaturat mesatare të ajrit, të vërtetuara gjatë muajit qershor 2021 si dhe vlerat e normës referuar periudhës shumëvjeçare 1961÷1990. Gjithashtu për ecurinë ditore të temperaturave janë përzgjedhur disa vendmatje që i përkasin zonave dhe nënzonave të ndryshme klimatike të Shqipërisë, të cilat janë paraqitur në figurën Nr.9. Anomalitë më të theksuara të temperaturave të ajrit të vlerësuar në shkallë kontinentale dhe të paraqitura në figurën Nr.6 evidentojnë për vendin tonë një situatë më të veçantë në dhjetëditëshin e fundit të muajit qershor. Situata me vlerat e temperaturave maksimale të ajrit në shkallë kontinentale paraqitet në vijim në figurën Nr.10.

Sa i takon vendit tonë ajo paraqitet grafikisht me të dhënat e disa vendmatjeve meteorologjike në figurën Nr.7, ku dukshëm evidentohej një anomalë prej rreth +4.3°C.

In the territory of Albania for the month of June 2021, the average air temperatures were accompanied by a gradual increase, which was more pronounced in the last ten days. Figure No.5 presents some data of meteorological stations for average air temperatures, observed during June 2021 and the values of the norm referring to the multi-year period 1961÷1990. Also, for the daily performance of temperatures, some stations have been selected that belong to different climatic zones and sub-zones of Albania, which are presented in figure No.9.

The most pronounced anomalies of air temperatures estimated on a continental scale and presented in Figure No.6 highlight a more specific situation for our country in the last ten days of June.

The situation with the values of maximum air temperatures on a continental scale is presented in the following figure No.10.

Regarding our country, it is presented graphically with the data of some meteorological stations in figure No.7, where is evident an anomaly of + 4.3°C.




Figura Nr.6 - Vlerat e anomalive të temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin European për disa javë të muajit qershor 2021, sipas NOAA-s. / Values of mean air temperatures for the European continent for some weeks of June 2021, according to NOAA.




Figura Nr.7 - Vlerat e temperaturave mesatare maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2021 për Shqipërinë. / Values of mean maximal air temperatures for some meteorological stations of June month 2021 for Albania.




Figura Nr.8. - Vlerat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2021 për Shqipërinë. / Values of maximal absolute air temperatures for some meteorological stations of June month 2021 for Albania.

Ndonëse në shkallë kontinentale u shënuan temperatura të larta dhe valë të të nxehtit, që përcollën dhe problematika në disa vende të kontinentit, për vendin tonë ku gjithashtu nuk munguan vlerat e larta të temperaturave maksimale ditore, duhet thënë se nuk u thyen rekordet kombëtare historike. Për më shumë informacion në lidhje me temperaturat maksimale absolute të ajrit janë përpunuar të dhënat e disa vendmatjeve meteorologjike dhe janë paraqitur në grafikun e dhënë në figurën Nr.8.

Si muaji i parë i stinës së verës dhe ku shënohet dhe momenti i solsticit veror me 21 qershor, duhet thënë se edhe temperaturat e natës ashtu sikundër ka ndodhur shpesh në vitet e fundit shënuan vlera më të larta se ato të normës.

Në figurën Nr.12 paraqiten të dhënat për disa vendmatje meteorologjike për territorin e Shqipërisë.


Although high temperatures and heat waves were recorded on a continental scale, which conveyed problems in some countries of the continent, for our country where the high values of maximum daily temperatures were also present, it must be said that national historical records were not exceeded.

For more information regarding the absolute maximum air temperatures, the data of some meteorological stations are processed and presented in the graph showed in figure No.8.

As the first month of the summer season and also marked the summer solstice on June 21, it must be said that the night temperatures, as has often happened in recent years, marked higher values than those of the norm.

The figure No.12 presents the data for some meteorological stations for Albanian area.

Figure Nr.9/1+9/12 - Temperaturat ditore për disa vendmatje meteorologjike për muajin qershor 2021 në Shqipëri.
The daily temperatures for some meteorological stations for June month 2021 in Albania.






Figura Nr.10 - Vlerat e temperaturave maksimale ekstreme të ajrit për kontinentin European për disa nga javët e muajit qershor 2021, sipas NOAA-s. / Extreme maximal values of air temperatures for European Continent for some weeks of June 2021, according to NOAA.




Figura Nr.11 - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për kontinentin European për disa nga javët e muajit qershor 2021, sipas NOAA-s. / Extreme minimal values of air temperatures for European Continent for the some weeks of June 2021, according to NOAA.




Figura Nr.12. - Vlerat e temperaturave mesatare minimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2021 për Shqipërinë. / Values of mean minimal air temperatures for some meteorological stations of June month 2021 for Albania.




Figura Nr.13. – Vlerat e temperaturave minimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë për muajin qershor 2021. / The values of minimal air temperatures for some meteorological stations of Albania for June month 2021.

Gjatë muajit qershor 2021 u vërtetuan dhe një sërë netësh tropikale mbi vlerat e normës. Netët tropikale konsiderohen netët kur temperaturat e ajrit gjatë natës nuk ulen poshtë nivelit të 20°C. Në vijim në tabelën Nr.1 paraqitet ky tregues për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë.

During the June 2021, a series of tropical nights were observed above the norm values. Tropical nights are considered nights when night time air temperatures do not fall below 20°C. In the following table No.1 is presented this index for some meteorological stations of our country.

Table Nr.1. – Numri i netëve tropikale për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë për muajin qershor 2021. / The tropical night number for some meteorological stations of Albania for the June month 2021.

Nr.	Vendmatja meteorologjike	Numri i netëve tropikale Tropical night number
1	Belsh	9
2	Brataj	5
3	Bushat	6
4	F. Klos	9
5	Koplik	10
6	Korçë	2

Nr.	Meteorological stations	Numri i netëve tropikale Tropical night number
7	Krujë	10
8	Petresh	9
9	Prenjas	1
10	Rapsh	7
11	Tiranë	13
12	Ura Shtrenjtë	2

Reshjet atmosferike të vrojtuar gjatë muajit qershor 2021 në shkallë kontinentale u paraqitën me mungesë dhe anomali negative, ku një informacion më i detajuar për kontinentin Europian jepet në figurën Nr.14. Sa i takon shpërndarjes në rajonin e gadishullit Ballkanit shpërndarja më e detajuar jepet në figurën Nr.15.



Atmospheric precipitation observed during June 2021 on a continental scale was presented with deficiency and negative anomalies, where a more detailed information about the European continent is given in figure No.14. Regarding the distribution in the region of the Balkan Peninsula, the most detailed distribution is given in Figure No.15. Generally, in the territory of Albania measured precipitation values were below the norm (-36.1%). The south-eastern region of the country is different from the rest and is characterized by the value above the norm as can be evidenced by the image presented in figure No.19. Should be noted that these positive anomalies are not characteristic of the SE area of the country. In figure No. 16 graphically are shown the values of stations that can be evident values above the norm in the SE area.





Figura Nr.14. - Reshjet për muajin qershor 2021 në kontinentin Europian dhe anomalië kundrejt periudhës 1981÷2010, sipas NOAA-s. / Rainfall for June 2021 at the European continent and their anomalies referring to the period 1981÷2010 according to NOAA.




Figura Nr.15. – Reshjet për muajin qershor 2021 në zonën e Ballkanit (në mm). / The precipitations for June month 2021 in Balkan

Një shpërndarje e reshjeve në hapësirë për muajin qershor 2021 për Shqipërinë paraqitet në hartën e dhënë në figurën Nr.19, ku pjesa pjesa JL e vendit rezulton me një situatë deficitare krahasuar me vlerat e normës.

A distribution of precipitation in space for the month of June 2021 for Albania is presented in the map given in figure No.19, where part SE of the country results in a deficit situation compared to the norm values.

Duhet theksuar se reshjet gjatë muajit qershor 2021 herë herë patën karakter lokal, karakteristikë e ndikimit të kushteve topografike për këtë stinë, e cila mbizotëron në mjaft raste për kundrejt reshjeve me natyrë frontale. Në vijim në figurën Nr.17 paraqiten të dhënat e numrit të ditëve me reshje mbi 1.0mm dhe reshjet maksimale 24 orëshe në figurën Nr.18.

It's important to be noted that the rainfall during June 2021 sometimes had a local character, characteristic of topographic conditions impact for this season, which prevails in many cases compare to rainfall of a frontal nature. The following in figure No.17 are presented the number of days with precipitation over 1.0mm & the maximum rain of 24 hours in figure No.18.




Figura Nr.16. – Lartësia e reshjeve për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2021 për Shqipërinë. / The amount of precipitations for some meteorological stations of June month 2021 for Albania.




Figura Nr.17. – Numri i ditëve me reshjeve mbi pragun 1.0 mm për disa vendmatje meteorologjike për muajin qershor 2021 për Shqipërinë. / The number of days with precipitations over the threshold 1.0 mm for some meteorological stations of June month 2021 for Albania.





Figura Nr.18. – Lartësia e reshjeve maksimale 24 orëshe për disa vendmatje meteorologjike për muajin qershor 2021 për Shqipërinë. / The maximal 24 hour of precipitation values for some meteorological stations of June month 2021 for Albania.



Disa tregues të tjerë mbi shpërndarjen hapësinore të anomalive të reshjeve për muajin qershor 2021, numrin e ditëve me reshje si dhe ato maksimale 24 orëshe janë dhënë në figurën Nr.20 (a,b,c).

Some other indicators on the spatial distribution of precipitation anomalies for the month of June 2021, the number of rainy days as well as the maximum 24-hour are given in Figure No.20 (a, b, c).






Figure No. 20 – Shpërndarja hapësinore e anomalive të reshjeve për muajin qershor 2021 kundrejt normës (a), numrit të ditëve me reshje mbi pragun 1.0mm (b) si dhe reshjet maksimale 24 orëshe (c).

Spatial distribution of precipitation anomalies for the month of June 2021 against the norm (a), the number of days with precipitation above the threshold 1.0mm (b) and the maximum precipitation of 24 hours (c).







Figura Nr.21. – Numri i ditëve me reshjeve mbi pragu 10.0 mm për disa vendmatje meteorologjike për muajin qershor 2021 për Shqipërinë. / The number of days with precipitations over the threshold 10.0 mm for some meteorological stations of June month 2021 for Albania.

Situata e reshjeve nën normë gjatë muajit qershor 2021 ishte vijim i një situatë të ngjashme dhe për gjithë muajt e mëparshëm të stinës së pranverës 2021 për Shqipërinë. Në figurën Nr.22 paraqiten të dhënat (në %) të anomalive të reshjeve për stinën e pranverës, ku qartë dallohet për pjesën më të madhe të territorit një situatë deficitare, e cila më e theksuar paraqitet në pjesën jugore të vendit.



The situation of below normal rainfall during June 2021 was a continuation of a similar situation for all previous months of the spring season 2021 for Albania. Figure No.22 presents the data (in %) of precipitation anomalies for the spring season, which clearly distinguishes for most of the territory a deficit situation, which is most pronounced in the southern part of the country.

Figura Nr.22. – Anomalitë (në %) të reshjeve për stinën e pranverës 2021 për Shqipërinë.

The precipitation anomaly (in %) for spring season 2021 for Albania.




Figura Nr.23. – Vlerat e përlogaritura të avullimit për muajin qershor 2021 për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë. / The calculated values of evaporation for June month 2021 for some meteorological stations of Albania.

Natyrisht një nivel më i ulët i reshjeve si normë, sidomos sa i takon atyre të vlerave maksimale mundësuan dhe nivele më të larta të avullimit. Kësisoj u rrit mundësia e shfaqjes së thatësisë si në rajon ashtu dhe për Shqipërinë. Në vijim në figurën Nr.24 paraqiten të dhënat e treguesit të thatësisë SPI dhe të reshjeve (percentilet) për muajin qershor 2021 për rajonin e Ballkanit, ku gjysma veriore e Shqipërisë karakterizohet me thatësi të moderuar.

Matter of course, a lower level of precipitation and a performance of air temperatures above the norm, especially in terms of those of maximum values enabled higher levels of evaporation. This increased the possibility of drought in the region and for Albania. The following in Figure No.24 are presented the data of the SPI drought indicator and precipitation (percentiles) for the month of June 2021 for the Balkan region, where the northern half of Albania is characterized by moderate drought.




Figura Nr.24. – Treguesi i thatësisë SPI për muajin qershor 2021 në zonën e Ballkanit. / The drought index for June month 2021 in Balkan area.




Figura Nr.25. – Vlerat e percentileve për reshjet për muajin qershor 2021 në zonën e Ballkanit. / The percentiles values of precipitations for June month 2021 in Balkan area.

Në procesin e rianalizës së të dhënave ose situatave të veçanta të motit një vlerë të rëndësishme kanë dhe të dhënat mbi parashikimin 24 orësh të reshjeve, të cilat ndihmojnë në saktësimin hapësinor ose kohor të vlerësimeve të ndryshme meteorologjike.

In the process of re-analyzing data or specific weather situations, data on 24-hour rainfall forecasting have an important value, which help in spatial or temporal accuracy of various meteorological estimates.





Figura Nr.26. – Vlerësimi i reshjeve të pritshme çdo ditë, për 24 orët në vijim sipas platformës “SEEFFG” për muajin qershor 2021. / The estimation for the expected precipitation on the next 24 hours according to the platform “SEEFFG” for June month 2021.

Të dhënat mbi reshjet e parashikuara 24 orëshe janë një informacion i rëndësishëm për të ri-analizuar situatën mbizotëruese me reshje për muajin qershor 2021, të cilat sipas produkteve të platformës SEEFFG, janë paraqitur në figurën Nr.26.

The forecast data on 24-hour precipitation is an important information to re-analyze the prevailing precipitation situation for June 2021, which according to the products of the SEEFFG platform, are presented in Figure No.26.



Moti ekstrem. - Gjatë muajit qershor 2021 u vërtetuan 7 stuhi të kategorisë së parë, tetë të kategorisë së dytë dhe dy të kategorisë së tretë. Stuhitë u vërtetuan në Mesdhe dhe në Europën qendrore. Stuhitë u shoqëruan me reshje erëra, tornado dhe shkarkes elektrike. Për ilustrim në figurën Nr. 27 paraqitet një ndër situatat e parashikimit të stuhive në shkallë kontinentale vlerësuar më datë 24 qershor 2021 (ESTOFEX).



Extreme weather. During June 2021, 7 first category storms, eight second category storms and two third category storms were observed. The storms were observed in the Mediterranean and Central Europe. The storms were accompanied by precipitation, winds, tornadoes and electrical discharges. For illustration in figure No. 27 is one of the continental scale storm forecast situations issued on June 24, 2021 (ESTOFEX).




Figura Nr.27 – Situata e parashikimit të stuhive në datë 24 qershor 2021 ora 00:21 UTC për kontinentin European e vleshme për dy ditët në vijim nga data 24.06.2021 ora 06:00 deri datë 25.06.2021 ora 06:00 UTC. / Storm forecast situation on 24 June 2021 at 00:21 UTC for the European continent valid for the following two days from 24.06.2021 at 06:00 to 25.06.2021 at 06:00 UTC.

Në figurën Nr.28 paraqitet situata 48 orëshe e rrufeve e datave 10-12.06.2021 me një numër total prej 59.312 goditjesh, ndërsa në figurën Nr.29 paraqitet situata për muajin qershor 2021 me një numër total të rrufeve prej 1.366.300 goditjesh.

In figure no.28 is presented the 48-hour lightning situation dated 10-12.06.2021 with a total number of 59.312 strikes, while figure No.29 presents the situation for June 2021 with a total number of lightning strikes of 1.366.300.






Figure Nr.28 - Situata e rrufeve nga data 10.06.2021 ora 00:00 UTC deri në datën 12.06.2021 ora 00:00 UTC. / Lightning situation from 10.06.2021 at 00:00 UTC until 12.06.2021 at 00:00 UTC.




Figure Nr.29. - Numri total i rrufeve në kontinentin European gjatë muajit Qershor 2021. / Total number of lightning strikes on the European continent during June 2021.

Gjatë muajit qershor 2021 u vrojtua dhe prania e pluhurit me origjinë nga kontinenti Afrikan.

During June 2021, was present the dust originating from the African continent.

Nga interpretimi i të dhënave në figurën Nr.30, është e dukshme se shpërndarja mesatare gjeografike në rajonin e Mesdheut të pluhurit me origjinë Afrikane, për muajin qershor, ka prekur brigjet e Afrikës veriore, Apennine and also the west part of Balkan Peninsula.

perëndimore të gadishullit të Ballkanit. Vlerat mesatare mujore të shpërndarjes gjeografike të grimcave të pluhurit Afrikan për rajonin e vendit tonë janë të ulta me vlera që nuk i kalojnë 0.4 g/m^2 .




Figura Nr.30 – Vlerat mesatare të shpërndarjes së pluhurit afrikan gjatë muajit qershor (në mgr/m^2) ora 00 UTC sipas platformës SKIRON të Universitetit të Athinës.

The average values of African dust distribution during June (in mgr/m^2) at 00 UTC according to the SKIRON platform of the University of Athens.

